

## Informacion për Prindërit ose Kujdestarët Provimet “Keystone” të Pensilvanisë



### Çfarë janë Provimet “Keystone”?

Provimet Keystone janë provime të mbarimit të lëndës, të konceptuara për të vlerësuar aftësitë e fituara në përmbajtjen mësimore. Duke filluar nga klasa e vitit 2017, nxënësit duhet të tregojnë aftësitë në Provimet Keystone në lëndët Algjebra 1, Letërsi dhe Biologji, në mënyrë që të diplomohen. Nxënësit do të kenë mundësi të ndryshme për realizimin e provimeve Keystones, përgjatë gjithë kohës që janë në shkollë të mesme.

### Kush do të marrë pjesë në Provimet “Keystone”?

Duke filluar nga viti shkollor 2012-2013, Provimet Keystone në Algjebra I, Letërsi dhe Biologji, do të zëvendësojnë testet PSSA të klasës së 11-të (Sistemi i Pensilvanisë për Vlerësimin e Shkollës) në matematikë, lexim dhe shkencë, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësive të nxënësit, mësuesit dhe shkollës. Nxënësit do t'i nënshtrohen provimeve Keystone, pranë ose në përfundim të lëndës së parashikuar si provim. Rezultatet e nxënësve depozitohen gjatë vitit të parë të shkollës për qëllime përgjegjësie dhe ato të vitit të fundit të shkollës shërbejnë në kuadrin e diplomimit. Disa nxënës që e kanë përfunduar lëndën që lidhet me provimet Keystone, por nuk e kanë kaluar provimin Keystone, do të marrin pjesë në kuadrin e vlerësimit. Në vazhdim, nxënësit që e kanë kaluar testin Keystone, por nuk kanë arritur rezultat të kënaqshëm, mund të rimerren në provim.

### Kur do të bëhen provimet?

Provimet Keystone do të bëhen tre herë gjatë çdo viti shkollor — dimër, pranverë dhe verë. Datat specifike të provimit do të publikohen nga Departamenti i Edukimit të Pensilvanisë

### Kush përcakton se çfarë do të testojnë Provimet “Keystone”?

Grupe edukatorësh nga e gjithë Pensilvania, përcaktojnë fushat e njohurive ku janë bazuar Provimet Keystone. Në këto grupe përfshihen mësues, supervizorë, drejtues kurrikule dhe specialistë të kolegjeve. Këto grupe gjithashtu rishikojnë, publikojnë dhe miratojnë pyetjet e provimit.

### Çfarë do të vlerësohet në Provimet “Keystone”?

Pensilvania ka adoptuar Standardet Bazë të Përgjithëshme, standarde që janë në një linjë me

pritsmëritë për sukses në shkollë të lartë dhe në sferën e punës. Keystonet janë konceptuar për matjen e këtyre standardeve.

*Translation and Interpretation Center*  
4/2014

### Sa kohë do të vazhdojnë Provimet “Keystone”?

Nuk ka limit kohor për një nxënës që të përfundojë Provimin Keystone. Secili Provim Keystone mund të kërkojë 2-3 orë për përfundim, bazuar në një nxënës tipik. Janë dy module në çdo provim dhe çdo modul (ose seksion provimi) i Testit Keystone, do të kërkojë 1 deri 1.5 orë për t'u përfunduar. Drejtoria mund të zgjedhë që të zhvillojë Provimin Keystone gjatë dy ditëve, ose t'a zhvillojë të ndarë në mëngjes dhe pasdite, të së njëjtës ditë.

### Cilat janë formatet e vlefshme për administrimin e Testeve “Keystone”?

Provimet Keystone janë të mundshme në versionin online, ose me letër dhe stilolaps. Drejtoria Arsimore do të përcaktojë nëse këto formate do të përdoren veçmas, ose të dyja. Ushtrimet ndihmëse të praktikimit për provimet, gjithashtu do të jenë në formatet online, ose me letër dhe stilolaps.

### A do të kenë mundësi nxënësit të praktikojnë teste të ndryshme, përpara provimit online të Testeve “Keystone”?

Janë zhvilluar programe të ndryshme për t'u ushtruar në praktikimin me letër, si dhe në online për Provimet Keystone. Praktikimi Online i Vlerësimit të Nxënësve, përdor piktura, lëvizje dhe zë, për përshkrimin pamor dhe me zë të karakteristikave të sistemit të PA, për Vlerësimin online. Nxënësit lejohen të praktikohen sa herë e dëshirojnë, ose e kanë të nevojshme. Mjetet e Praktikimit Online (OTT) ofrojnë një eksperiencë njohëse duke përdorur vlerësimin online të PA, që i lejon nxënësit të bëjnë ushtrime testesh të PA online, përpara se të bëjnë provimin e vërtetë Keystone. Përmes OTT, nxënësit gjithashtu do të kenë mundësinë të ushtrorjnë dhënie e përgjigjeve në formën e shtjellimit të përgjigjes, në funksione grafike dhe ndërtimin e ekuacionit duke përdorur mjetet përkatëse në dispozicion. Provimet online gjithashtu kanë një tipar “Help”, i cili është i vlefshëm për të ndihmuar nxënësit gjatë provimit.

*PA Keystone Exams Information for Parents*  
*Albanian*

## **Çfarë pyetjesh janë në Provimet “Keystone”?**

Provimet Keystone do të përfshijnë pyetje me shumë zgjedhje (multiple-choice) dhe pyetje me formulim përgjigje (open-ended). Në Provimet Keystone, afërsisht 60% deri 75% të vlerësimit total do të jetë nga pyetjet me shumë zgjedhje dhe 25% deri 40% e vlerësimit të përgjithshëm do të jetë nga pyetjet me formulim përgjigje.

## **Si vlerësohen përgjigjet e pyetjeve që kërkojnë shtjellim?**

Përgjigjet me shkrim për pyetjet me formulim, vlerësohen nga specialistë të trajnuar në aplikimin e sistemit të vlerësimit. Vlerësimi do të bazohet vetëm në përmbajtjen e tyre. Rregullat e drejtëshkrimit nuk do të kenë vlerë në masën e vlerësimit. Shumica e pyetjeve që kërkojnë formulim, kërkojnë nga nxënësit të shfaqin njohuritë e tyre, ose shpjegojnë arsyetimin e bërë. Këto pyetje në Provimet Keystone do t'u kërkojnë nxënësve të shpjegojnë, analizojnë, përshkruajnë, ose krahasojnë. Disa pyetje gjithashtu do të kërkojnë nga nxënësit që të kryejnë llogaritje, ose krijojnë grafikë, skica ose diagrama.

## **Si do të raportohen rezultatet?**

Rezultatet e Provimeve Keystone do të nxirren sa më shpejt që të jetë e mundur dhe do të përcillen në Drejtorinë Arsimore. Dy kopje të rezultateve individuale të secilit nxënës do të dërgohen në Drejtorinë Arsimore dhe në shkollat çarter. Një kopje do të dërgohet në adresën e shtëpisë të prindërve/kujdestarëve; tjetra do të mbahet nga shkolla/drejtoria. Relacionet në nivelin e shkollës do të përdoren për qëllime planifikimi mësimor. Drejtoritë Arsimore dhe shkollat çarter mundet t'i publikojnë rezultatet e Provimeve Keystone për secilën shkollë. Shteti gjithashtu do të publikojë të dhënat e provimeve për secilën shkollë.

## **A kanë mundësi prindërit t'i rishikojnë Provimet “Keystone”?**

Prindërit dhe kujdestarët mund ti rishohin Provimet Keystone dhe nëse ata besojnë se mund të ketë konflikt me besimet e tyre fetare, bëjnë marrëveshje për rishikim me Koordinatorin e Provimeve të Shkollës, menjëherë sapo testet vijnë në shkollë. Marrëveshjet konfidenciale duhet të firmosen dhe në këtë rast asnjë kopje e Provimeve Keystone, ose shënimeve rreth pyetjeve të provimit, nuk mund të merret me vete jashtë shkollës. Nëse pas rishikimit të Provimeve Keystone, prindërit ose kujdestarët nuk duan që fëmija i tyre të marrë pjesë në një, ose në të gjitha provimet, për shkak të konfliktit me bindjet e tyre fetare, ata duhet t'i drejtohen me shkrim Superintendentit të Drejtorisë Arsimore, ose CAO të shkollës çarter, përpara fillimit të provimit(eve), ku të kërkojnë përjashtimin e fëmijës së tyre nga provimi(et).

## **Çfarë janë Vlerësimet e Bazuara mbi Projekt (PBAs)?**

PBA\_të janë vlerësime në të njejtën linjë me modulet e Provimeve Keystone. Ato ofrojnë një alternative për plotësimin e kërkesave të diplomimit të shtetit, që do të fillojnë nga klasa që diplomohet në vitin 2017. Pas dy përpjekjeve të dështuara në testin Keystone, nxënësit mund të zgjedhin PBA, në modulet e testit Keystone, ku ata nuk kanë kaluar. PBA\_të janë të sigurta, zhvillohen nën mbikëqyrjen e shkollës, dhe pas përfundimit, vlerësohen nga persona të caktuar nga shteti. Për më tepër informacion vizitoni <http://www.pdesas.org/module/assessment/About.aspx>

Përjashtimi për arsye fetare bëhet vetëm për provimet Keystone. Kjo nuk pranohet në PBA. Nxënësit e klasës 2017 dhe më tej, që përjashtohen nga Provimet Keystone, mundet gjithsesi të plotësojnë dhe demonstrojnë aftësi në PBA, në mënyrë që të diplomohen.

***Për më tepër informacion rreth Provimeve Keystone, vizitoni uebsajtin e SAS [www.pdesas.org](http://www.pdesas.org), ose kontaktoni drejtorinë tuaj arsimore.***